

Fillimi > Kronikë

Armë, para dhe 430 kg kokainë/ Dalin pamjet e operacionit në Fier, si u zbulua banesa e zyrtarit të PS, policia ‘blindoi’ fshatin në pak minuta

25 Nëntor, 2022 20:50



Madhësia e tekstit: - +

Këto janë pamjet e megaoperacionit antidrogë të koduar “Konsistenca”, i zhvilluar nga Policia e Shtetit, nën drejtimin e SPAK, dhe në bashkëpunim me Policinë malazeze dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese.

Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë përfunduar me sukses dhe në një konspiracion të plotë, hetimet në kuadër të një procedimi penal, për një grup të strukturuar kriminal në fushën e trafikimit të drogave të forta (kokainë), me angazhimin e një numri të konsiderueshëm të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të agentëve gjyqësorë dhe kanë ekzekutuar deri më tani, për 10 shtetas, masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprën penale “Trafikimi i lëndëve narkotike”, kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal.

Gjithashtu, strukturat e Policisë kanë kryer kontrollin e 14 ambienteve, në qytete të ndryshme (Tiranë, Lushnjë dhe Fier), dhe si rezultat, janë sekuestruar: 6 armë zjarri, 2 armë gjahu, municion luftarak, rreth 16 000 euro dhe 20 paleta me rreth 24 ton “pleh artificial”, brenda të cilit, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova se gjendet një sasi prej rreth 430 kg lëndë narkotike kokainë, vlera e së cilës, referuar shitjes në tregun me pakicë, kap shifrën rreth 40 milionë euro.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku nëpërmjet një mesazhi, ka falënderuar të gjithë trupën policore të angazhuar për finalizimin me sukses të këtij megaoperacioni. Ky megaoperacion tregoi integritetin dhe profesionalizmin e strukturave policore, në luftën pa kompromis ndaj fenomeneve kriminale.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Droge, fier, SPAK

TË NGJASHME



Shkatërrohet banda e drogës në Angli/ Klientët porosisnin me telefon dhe..., si funksiononte skema 'gjeniale' e 4 shqiptarëve

25 Nëntor, 2022



Zbulimi i laboratorit të kokainës në Fier, gazetari Hoxha: Uroj që SPAK të ketë gjetur fije të tjera, në jug të vendit ka tjetër laborator droge

25 Nëntor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Lëvizte pa patentë në mes të Hamburgut, të riut shqiptar iu gjet në makinë dhe...

25 Nëntor, 2022



U arrestua për kokainën në Fier, ish-kryekomunari i PS punonte si drejtor në OST, vartës i Belinda Ballukut me rrogë 2 milionë lekë

25 Nëntor, 2022



Raporti Botëror, Shqipëria në mesin e 10 vendeve të para për kultivimin dhe shitjen e kanabisit

25 Nëntor, 2022




Aksidenti të moshuarin që më pas ndërroi jetë, përfundon në pranga 56-vjeçari në Fier (EMRI)

25 Nëntor, 2022



Laboratori i drogës në Frakull, zbulohet roli i kolumbianëve. Zbardhet itinerari i ngarkesës me kokainë në pleh kimik

25 Nëntor, 2022



Përgjashtimi i Shefit të komisarariatit dhe ai i Krimeve në Berat, kush janë emrat që i zëvendësojnë


25 Nëntor, 2022

KATEGORIA VIDEO




"Izolimi duke mohuar liberalizimin e vizave, i padrejtë", Xhaça nga Prishtina: Mbështesim aspiratat e Kosovës për integrim euroatlantik

25 Nëntor, 2022



Armë, para dhe 430 kg kokainë/ Dalin pamjet e operacionit në Fier, si u zbulua banesa e zyrtarit të PS, policia 'blindoi' fshatin në pak minuta

25 Nëntor, 2022



"Rendi ndërkombëtar është sfiduar", ish-ministri Bushati në podcast-in e ri Lufta në Ukrainë ka prodhuar realitet të ri gjeopolitik

25 Nëntor, 2022



"Porositi vrasjen e avokatit", Gjikuari komenton akuzat ndaj Taulant Ballës: Nuk e di vërtetësinë, pyesni...

25 Nëntor, 2022



Zgjedhjet dhe situata në PD, Murati: Dy grupimet janë në të njëjtën 'varkë', por lundrojnë me remera në krahë të kundërt

25 Nëntor, 2022



Uni-klima hap showroom-in e sistemeve të kondicionimit Mitsubishi Electric

25 Nëntor, 2022

FAQET ZYRTARE

TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISE

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Autoktonët
Dola te Ola
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Jeta pa filter
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Në mëngjes me Klarkun
Në shënjestër
Open
Pikat mbi i
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today